

AKT NORMATIV
Nr.1, datë 25.5.2007

PËR LEJIMIN E HYRJES, NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË DISA NJËSIVE TË FORCAVE USHTARAKE TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, NË KUADËR TË OPERACIONIT TË MASAVE TË SIGURISË, PËR VIZITËN E PRESIDENTIT AMERIKAN NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 2, pika 3, 12, pika 3, dhe 101, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Lejimin e hyrjes, qëndrimit dhe të lëvizjes, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të njësive të forcave ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të mjeteve të tyre ushtarake, për pjesëmarrjen në operacionin e përbashkët për masat e sigurisë, para dhe gjatë vizitës së Presidentit të SHBA-së, në Shqipëri.

Neni 2

Republika e Shqipërisë, në kuadër të operacionit të përbashkët për masat e sigurisë, vë në dispozicion hapësirën tokësore, detare dhe ajrore, përfshirë portet dhe aeroportet, si dhe krijon lehtësitë e nevojshme për kryerjen e këtij misioni.

Neni 3

Njësitë e forcave ushtarake të SHBA-së, të angazhuara në operacionin e përbashkët për masat e sigurisë, lejohen të kryejnë veprimet e përshtatshme ndaj çdo lloj kërcënimi apo rreziku, që mund të cenojë sigurinë e vizitës, duke përdorur, nëse është e nevojshme, edhe forcën, në përputhje me intensitetin e rrezikut apo të kërcënimit.

Marrja e masave të përshtatshme ushtarake dhe reagimi, në raste kërcënimi e rreziku, parashikohen në marrëveshje teknike dypalëshe.

Ministri i Mbrojtjes autorizohet të negociojë dhe të nënshkruajë marrëveshjen teknike, për përmbushjen e këtij misioni.

Neni 4

Statusi i forcave ushtarake të SHBA-së është përcaktuar në “Marrëveshjen plotësuese ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës të “Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, në lidhje me statusin e forcave të tyre”, për statusin e forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë”, nënshkruar më datë 31.3.2004 dhe ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.9246, datë 24.6.2004.

Neni 5

Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e tjera shtetërore e strukturat në varësi të tyre, të cilave u kërkohet bashkëpunim, në kuadër të operacionit të përbashkët të masave të sigurisë, e ofrojnë menjëherë bashkëpunimin e kërkuar, sipas objektit të veprimtarisë shtetërore, që kryejnë në përputhje me

legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha